



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 25
Prishtinë, më 14 prill 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L
I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Rustem Mustafa, Bojan Stojanovič, Emrush Xhemajli, Eqrem Kryeziu, Melihate Termkolli, Gani Geci, Agim Veliu dhe Ibrahim Selmanaj.

Mungoi: Shkumbin Demaliaj, Zafir Berisha, Zylfi Merxha.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku dhe Blerina Pula.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Armën
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike
4. Të ndryshme

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Armën

Kryetari i Komisionit – tha, ne jemi Komision funksional dhe projektligji për armët në seancën e ardhshme plenare do të jetë në diskutim për tu shqyrtuar dhe miratuar në parim. Unë mendoj se ne si komision, ta rekomandojmë miratimin e tij në parim, pasi që ky Projektligj i plotëson kriteret e nevojshme. Gjithashtu unë propozoj që z.Shkumbin Demalijaj, të jetë sërish referues për këtë projektligj. A pajtoheni që ky ligj të shkojë në lexim të parë dhe Shkumbim Demalijaj të mbetet referues.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që Projektligji për Armën të miratohet në parim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ruajtjen e Rendit dhe Qetësisë Publike

Kryetari i Komisionit – tha, edhe ky Projektligj është në kompetencë të komisionit tonë. Edhe për këtë ligj propozoj që të shkojë për miratim në lexim të parë. Gjithashtu propozoi që z.Gani Geci, ta caktojë referues për këtë projektligj.

Anëtarët e komisionit u pajtuan që Projektligji për Ruajtjen e Rendit dhe qetësisë publike të miratohet në parim.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – tha, me organizim nga DCAF-i, nga data 5 deri me 8 prill në Ohër, është mbajtur një Trajnim mbarë qeveritar për mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e sektorit të sigurisë. Nga Komisioni ynë është dashur të prezantohen 4 deputetë dhe një zyrtarë nga stafi. Paraqitja e Komisionit nuk ka qenë në nivel pasi që nuk kanë shkuar atje shumica e delegacionit. Kjo praktikë nuk duhet të përsëritet herëve tjera. Seminarët dhe trajnimet janë pjesë e domosdoshme e punës dhe deputetët që caktohen për një seminar duhet të marrin pjesë. Obligimet që merren duhet të kryhen, prezantimi i komisionit duhet të bëhet në mënyrën më të mirë.

Gani Geci – Sa i përket trajnimit në Ohër unë kam qenë, mirëpo gjatë shkuarjes më kanë ftuar nga stafi i Kryetarit të Kuvendit për një takim. Pas këtij takimi, unë kam kërkuar të më kthejnë në Ohër, mirëpo nuk ka qenë e mundshme.

Kryetari i Komisionit- Është hartuar plani i veprimit për sfidat e progresit të Komisionit Evropian. Në këtë plan të veprimit, komisioni ynë ka shumë angazhime. Nga takimi i ardhshëm do të fillojmë me zbatimin e planit që veç e ka hartuar referuesi Emrush Xhemajli. Gjatë javës e mëmri në kutitë e juaja këtë plan të detajizuar.

Gjithashtu keni marr një raport të z. Naim Maloku, që ka qenë në një sesion të Asamblesë parlamentare të NATO-s dhe ka bërë këtë Raport për komisionin tonë. Pasi ne jemi komision për siguri, ky është veç raport njoftimi.

Në kuadër të pikës të ndryshme me kërkesë të z.Bojan Stojanovic, hapi debat për çështjen e policëve serb që ende marrin paga edhe pse nuk vijnë punën. Ju e dini se ne i kemi dërguar rekomandimet tona dy herë, për Kryesinë e Kuvendit në lidhje me këtë çështje.

Gani Geci – Në grupin tonë parlamentar është njoftuar nga ana e përfaqësuesit tonë, që merr pjesë në mbledhje të Kryesisë, se ne si komision për siguri, kemi vërejtje për rekomandimet se nuk i dërgojmë si duhet. Këtu shtohet çështja se, rekomandimet tona a duhet të bisedohen në Kryesi të Kuvendit ,apo duhet të hyjnë si pikë e veçantë e rendit të ditës në Kuvendin e Kosovës.

Kryetari i Komisionit – Rekomandimet e bëra janë votuar në Kryesi, mirëpo ne paraprakisht nuk i kemi dërgua edhe për seancë.

Eqrem Kryeziu – Nëse diçka i drejtohet Kryesisë është e drejtë e saj që të merret me të.

Melihate Termkoll – Komisioni i bën kërkesë Kryesisë që të bëhet diçka për rend dite. Rekomandimet i bën parlamenti, ato rekomandime duhet ti drejtohen Qeverisë dhe institucioneve tjera. Për një kohë të gjatë ne kërkojmë që të diskutohet çështja e sigurisë në vend, por ndoshta edhe kjo çështje nuk është adresuar si duhet. Duhet të bëhet një kërkesë Kryesisë që çështja e sigurisë të debatohet në Parlament.

Kryetari i Komisionit – Ne i kemi drejtuar rekomandime Qeverisë dhe të gjitha institucioneve tjera përkatëse përmes kryesisë së Kuvendit, e cila i ka votuar këto rekomandime. Znj.Termkoll ka të drejtë për kërkesën që çështja e sigurisë me theks të veçantë në disa vende të Kosovës të debatohet në seancë plenare.

Emrush Xhemajli – Çështja konkrete që e ngriti z.Stojanovic në lidhje me policët serb të cilët nuk vijnë punën që 14 muaj është mjaft serioze. Në takim me Ministrin Zenun Pajaziti dhe drejtorin e policisë z.Ahmeti, ata janë zotuar se do të punojnë në këtë drejtim. Edhe në takim me përfaqësuesin e EULEX-it, na është thënë se kjo çështje është përgjegjësi e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe e Policisë së Kosovës. Kërkesa jonë si Komision është të merren rekrut të rinj serb dhe të hyjnë në polici, sepse kriminaliteti po rritet në zonat ku nuk ka polic të mjaftueshëm. Propozoj që edhe njëherë të thirret Ministri i Punëve të Brendshme dhe drejtori i policisë.

Eqrem Kryeziu – Unë e kam përcjell shqetësimin e z.Stojanovic dhe jam munduar të marr pozicionin tim në lidhje me këtë çështje. Kjo është tolerancë e pakuptimtë që policët të marrin paga edhe pse nuk punojnë. Unë mendoj se zhvlerësohet influenca e vet liderëve serb. Nëse ne dëshirojmë më shumë mirëkuptim nga komuniteti serb, duhet ta forcojmë rolin e njerëzve që i mbrojnë interesat e tyre. Këtë çështje e shoh më delikate sepse zhvlerësimi i liderëve serb është më i rrezikshëm se sa pagat nga buxheti, por edhe çështja e pagave është absurde.

Bojan Stojanovic – Që një kohë të gjatë jemi duke e diskutuar çështjen e policëve që nuk shkojnë në punë dhe vazhdojnë ti marrin pagat. Njerëzit që paguhen gjithsesi duhet të punojnë. Unë edhe më herët kam diskutuar për mënyrën se si ti bindim ata në kthimin e

tyre. Këta pjesëtar që nuk shkojnë në punë, ata njëkohësisht edhe mund të punojnë ndonjë punë tjetër dhe në të njëjtën kohë pranojnë edhe pagën e policisë. Nuk e di mendimin e tyre se pse po vendosin të mos kthehen në punë, por ne duhet të sjellim vendime konkrete se çka duhet të bëjmë në këtë rast. Ka njerëz që presin të kyçen në policin e Kosovës. Ne kërkojmë përkrahjen aktive të komunitetit serb në të gjitha strukturat dhe proceset, në marrjen e vendimeve në Kosovë. Për ta zgjidhur këtë problem unë mendoj se ne duhet tu japim afat prej një muaji se a dëshirojnë të kthehen dhe pastaj të suspendohen pa pagesë.

Një çështje tjetër, sa i përket trajnimit në Ohër, unë deri në momentin e fundit nuk kam pasur agjendën dhe materialet dhe për këtë kërkoj nga organizatorët që të përkujdesen më herët për këtë.

Gani Geci – Unë mendoj se z.Stojanovic në seancën e ardhshme të propozon këtë çështje. Mund të propozon edhe në emër të Komisionit, unë pajtohem plotësisht me këtë dhe nuk dëshiroj që ky diskutim të mbetet vetëm në mbledhje të komisionit.

Agim Veliu – Kjo është një praktikë e keqe që po vazhdon, njerëzit që nuk punojnë të marrin të ardhura. Kjo praktikë ka qenë edhe më herët me punëtorët e arsimit. Duhet të fillohet të zbatohet ligji për të gjithë njëjtë.

Kryetari i Komisionit – Unë i kam disa propozime konkrete për këtë çështje. Javën e ardhshme të caktojmë një ditë dhe si Komision të shkojmë t'i vizitojmë Ministrin z. Pajaziti dhe drejtorin e policisë z.Ahmeti, të njoftohemi më shumë për këtë çështje. Pastaj në emër të Komisionit të ftojme Ministrin z.Pajaziti në seancë. A pajtoheni që javën e ardhshme të shkojmë në takime.

Melihate Termkoll – Ju mundeni të caktoni takime por kjo është çështje e vendimit politik të Qeverisë dhe mendoj se këto çështje duhet të orientohen në Qeveri. Me takimet tona nuk zgjidhet kjo çështje, kjo zgjidhet me vendim politik të Qeverisë.

Gani Geci – Ne dëshirojmë t'iu japim shansin të gjithë atyre që e pranojnë shtetin e Kosovës, i pranojnë institucionet tona dhe mendoj se ka mjaft njerëz që presin të kyçen në polici.

Eqrem Kryeziu – Është e vërtetë ajo që tha znj.Melihate që kemi të bëjmë me vendim politik. Ne do të dëshironim që kryeministri apo përfaqësuesit ndërkombëtarë të na bindin që ne si komision e kemi gabim që po kërkojmë zgjidhjen e kësaj çështje.

Bojan Stojanovic – tha, nuk e kam ditur që do të zgjasin këto polemika, unë nuk e kam nisur këtë problem, ky është problem që po diskutohet që një vit. Qëllimi im ishte që të gjendet një zgjidhje për problemin, unë mendoj se këtë çështje mund ta zgjidhin Ministri i MPB-së dhe drejtori i policisë dhe nëse këta mund ta zgjidhin këtë çështje, atëherë pse çështje të shkoj tek instancat më të larta. Duhet ti gjejmë serbët që i respektojmë institucionet, dëshirojnë të punojnë dhe i marrin pagat.

Kryetari i Komisionit – Vizita në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me drejtorin e policisë, bëhet me qëllim të marrjes së informatave zyrtare, në mënyrë që të procedohet sa më mirë kjo çështje. A pajtoheni me këtë propozim.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këtë propozim

Gani Geci – Në kuadër të pikës të ndryshme, duhet të cekim një çështje në lidhje me auto-shkollat e Republikës së Kosovës. Para Kuvendit janë duke protestuar për një udhëzim administrativ që e ka bërë Ministria e Transportit me të cilin nuk janë pajtuar auto-shkollat.

Kryetari i Komisionit – Ministria e Transportit nuk është vijë buxhetore e jona, por është punë e Kryesisë së Kuvendit.

Meqenëse nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit